

Data: 24.12.2022

KODI ETIK I ALEANCËS PËR SHQIPTARËT

Kodi i etikës në parti

Neni 1

Aleanca për Shqiptarët ka Kodin e saj të etikës i cili parashikon:

1. Kriteret e komunikimit dhe të marrëdhënieve etike brenda radhëve të saj dh në marrëdhënie me publikun;
2. Standardet e integritetit moral dhe etik që duhet të përmbushë çdo anëtarë gjatë ushtrimit të mandatit të tij si përfaqësues i partisë në organet e partisë dhe atë të qeverisjes lokale dhe qendrore;
3. Masat disiplinore për shkelen e Kodit të Etikës në parti si dhe procedurat që ndiqen në rastet e shkelje së saj

Qëllimi

Neni 2

Kodi i Etikës në parti ka si qëllim të përcaktoj rregullat që garantojnë sjelljen e anëtarëve të partisë dhe të përfaqësuesve të saj në të gjitha nivelet e drejtimit ose të përfaqësimit, në ushtrimin e detyrave dhe të drejtave të tyre., në marrëdhënie me strukturën ose forumin ku bëjnë pjesë, në raport me ligjet në fuqi dhe me kërkesat e dokumenteve bazë të partisë, Statutin dhe Programin e saj.

Fusha e Veprimit

Neni 3

Rregullat etike të këtij Kodi janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë anëtarët e partisë dhe përfaqësuesit e zgjedhur ose të emëruar të saj në të gjitha nivelet.

Parimet e përgjithshme

Neni 4

a) Zbatimi i ligjeve të shtetit

Anëtari dhe përfaqësuesi i partisë në çdo nivel përfaqësimi, në veprimtarinë e tyre, duhet të zbatojnë ligjet në fuqi si qytetar, por edhe në ushtrimin e kompetencave të tyre si përfaqësues i partisë, të zgjedhur apo të emëruar në një detyrë të caktuar.

b) Liria e mendimit

Anëtari i partisë dhe përfaqësuesi i saj në çdo nivel përfaqësimi duket të zbatoj dhe respektoj kërkesat që rrjedhin nga parimi i lirisë së mendimit dhe demokracisë së brendshme në parti.

c) Liria e zgjedhjes dhe fshehtësia e votës

Anëtari i partisë dhe përfaqësuesi i saj në çdo nivel përfaqësimi duket të zbatoj dhe respektoj kërkesat që rrjedhin nga parimi i lirisë së zgjedhjes dhe fshehtësisë së votës, të parashikuar në Statutin e Partisë.

ç) Parimi i mos diskriminimit

Anëtari i partisë dhe përfaqësuesi i zgjedhur ose i emëruar i saj, gjatë veprimtarisë ose në ushtrimin e funksionit përfaqësues, nuk duhet të favorizoj ose të diskriminoj cilindo, për shkak të gjinisë, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, aftësive të kufizuara etj.

d) Mos abuzimi me funksionin

Anëtari përfaqësues i partisë në çdo nivel përfaqësimi, në ushtrimin e funksionit të tij duhet të jetë i paanshëm, i drejtë, i arsyeshëm dhe i pavarur. Ai duhet të shmangë çdo veprim arbitrar ose çdo trajtim preferencial si dhe duhet të jetë i pandikuar nga çdo interes tjetër, personal, politik, familjar dhe shoqëror.

e) Transparenca, llogaridhënia dhe informimi i publikut

Veprimtaria e strukturave dhe forumeve të partisë në çdo nivel duhet të jetë transparente për anëtarët përkatës dhe publikun. Drejtuesit e tyre japin llogari para anëtarëve e publikut për veprimtarinë e tyre. Transparenca e veprimtarisë dhe informimi i publikut nga strukturat, forumet e anëtarët përfaqësues të partisë në çdo nivel përfaqësimi bëhet në respektim të kërkesave të kodit.

f) Konflikt i interesit

Anëtari përfaqësues i partisë në çdo nivel përfaqësimi duhet të parandaloj si dhe të marrë të gjitha masat për ndërprerjen e gjendjes së konfliktit ndërmjet detyrës së tij përfaqësuese dhe interesave të tij private.

Neni 5

Çdo anëtar i Aleancës për Shqiptarët është i detyruar të promovoj dhe të mbështesë parimet e parashikuara në nenin 4 të kësaj rregulloreje, në marrëdhëniet zgjedhore, organizative, drejtuese pse përfaqësuese.

Integriteti dhe standardet në përzgjedhjen e kandidatëve

Neni 6

1. Përfaqësuesi i partisë në funksione politike, në pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv në nivel qendror dhe lokal, duhet të karakterizohet nga standardet me të larta të integritetit moral, ligjor dhe profesional.
2. Çdo kandidat i propozuar nga Partia për t'u zgjedhur ose emëruar në funksion politik, detyrohet të nënshkruaj deklaratë në të cilën do deklaron se:
 - a) Nuk është i shkarkuar ose larguar nga asnjë detyrë e mëparshme për korrupsion pse shkelja të ligjit;
 - b) Do të zbatoj me korrektësi standardet ligjore të funksioneve për të cilat kandidon ose emërohet;
 - c) Do të zbatoj me korrektësi rregullat dhe normat e përcaktuara në dokumentet kryesore të Partisë;
 - d) Modeli i deklaratës që duhet të plotësojnë kandidatët për përfaqësim në drejtim dhe emërim në pozicione politike ose ekzekutive përgatitet e miratohet nga Kryesia e Partisë.
3. Personat që përjashtohen në bazë të Kodit të Etikës nuk mund të jenë kandidatë

për funksione të ndryshme përfaqësimi ose të mund të emërohen në çdo lloj detyre që ka mbështetjen politike të partisë.

Ushtrimi i mandatit në përputhje me ligjin, programin dhe Statutin e Partisë

Neni 7

1. Anëtari i strukturave drejtuese dhe përfaqësuese të ASH-së, në ushtrimin e mandatit të tij dhe në marrjen e vendimeve bazohet vetëm në rregullat e parashikuara në ligje, në Program dhe në Statut të Partisë.
2. Anëtari i strukturave drejtuese nuk duhet të marrë vendime që synojnë përfitime financiare e materiale për vete, familjen ose të afërmit si edhe përfitime politike të pamërituara.
3. Anëtari i strukturave drejtuese dhe përfaqësuese të ASH-së, detyrohet të mos vërë në detyrime financiare ose detyrime tjera jo të ligjshme ndaj individëve ose organizatave të cilat mund të ndikojnë në sjelljen, ushtrimin e mandatit dhe të pozicionit përfaqësues.
4. Në kryerjen e detyrave përfaqësuese, përfshirë aktivitetet publike, kontratat, emërimet, shpërblimet ose promovimet, anëtari i ASH-së vepron në bazë të parimeve të përzgjedhjes me transparencë dhe në bazë të meritës.

Transparenca në vendimmarrje dhe në ushtrimin e veprimtarisë

Neni 8

1. Anëtari i ASH-së i ngarkuar me mandat drejtues ose përfaqësues është përgjegjës për vendimet dhe veprimet e tij ndaj anëtarësisë dhe për çështje që lidhen me ushtrimin e mandatit të tij, ia nënshton veten verifikimit institucional prej organeve të partisë.
2. Në ushtrimin e mandatit drejtues ose përfaqësues, anëtari i partisë është i hapur dhe shpjegues për veprimet dhe vendimet që merr. Kufizimi i të drejtës për informim mund të pranohet vetëm nëse legjitimohet për interesa të qarta ligjore ose partiake.
3. I zgjedhuri ose i emëruari i partisë është i detyruar në çdo rast të deklaroj interesin privat të mundshëm që lidhet me detyrën e tij dhe të ndërmarrë veprime të qarta

për zgjidhjen e konfliktit të mundshëm të interesit në favor të interesit të anëtarësisë dhe publikut.

Shmangia e papajtueshmërisë së lidhjeve familjare në drejtim e përfaqësim

Neni 9

1. Nuk mund të jetë njëkohësisht në përbërje të së njëjtës strukturë drejtuese (Kuvend të Partisë, Kryesi të Partisë) persona që lidhen nga marrëdhëniet bashkëshortë, prind-bir/bijë, vëlla-motër.
2. Në rast se rezulton se në përbërjen e strukturave përkatëse drejtuese shfaqen këto parregullsi, çështja zgjidhet me dorëheqje ose me short.

KODI I ETIKËS NË MARRËDHËNIE ME PUBLIKUN

Neni 10

1. Kodi i Etikës në marrëdhënie me publikun synon rregullimin e marrëdhënieve të komunikimit të anëtarëve të ASH-së me publikun, me qëllim ruajtjen e kohezionit dhe shmangien e deklarimeve kontradiktor që krijojnë probleme e paqartësi për anëtarët dhe strukturat e ASH-së në bazë si dhe për publikun e gjerë.
2. Aleanca për Shqiptarët, anëtarët dhe strukturat e saj respektojnë të drejtat bazë dhe lirinë e shprehjes së individit të garantuara edhe me Statut. Anëtari i partisë nuk mund të veprojë në kundërshtim me Statutin dhe rregulloret e miratuara nga forumet drejtuese të ASH-së.
3. Anëtari i strukturave drejtuese e përfaqësuese të ASH-së në komunikimet publike ka parësore dhe respekton interesin e Programit politik dhe të Statutit të ASH-së, krijimin e një klime bashkëpunimi në përçimin e qartë në publik të qëndrimeve politike të ASH-së, në interes të rritjes së besueshmërisë dhe veprimit politik të saj.
4. Deklaratat publike të anëtarëve të strukturave të ASH-së, Asamblesë së Gruas dhe Forumit Rinorë, nuk mund të bien ndesh me linjën politike të miratuar në strukturat vendimmarrëse të partisë.

Rregullta e respektimit të Kodit të Etikës

Neni 11

1. Komunikimit me median për çështje që kanë të bëjnë me qëndrimet politike të ASH-së bëhen përmes Zyra për marrëdhënieve me publikun ose ne konsultim me të.
2. Anëtari i ASH-së i zgjedhur në organet drejtuese të Partisë dhe të forumeve të saja, nuk mund të shprehen në emër të ASH-së për çështje që kërkojnë një vendimmarrje politike pa u konsultuar më parë me strukturat përkatëse vendimmarrëse.
3. Sekretarët e ASH-së, shprehen për çështje politike sipas sektorëve që mbulojnë përveçse për çështjet të tjera për të cilat janë ngarkuar nga Kryetari i Partisë, Kuvendi apo Kryesia e Partisë. Deklarimi i tyre bëhet komform qëndrimeve politike të miratuara nga strukturat vendimmarrëse.
4. Anëtarët e Kryesisë dhe Kuvendit të Partisë, shprehen në media për çështje politike që kanë të bëjnë me qëndrimin e partisë sipas vendimeve të marra nga strukturat vendimmarrëse (Kongres, Kuvend, Kryesi). Në çdo rast deklarimet në media koordinohen me Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun në Parti.
5. Për vendimet e Kryesisë shprehet Kryetari i Partisë, zëdhënësi i Partisë pse një nga anëtarët e forumit i ngarkuar nga Kryetari i Partisë.
6. Për vendimet që merr Kuvendi i Partisë shprehet Kryetari i Partisë, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë ose një nga anëtarët e forumit i ngarkuar nga Kuvendi i Partisë.
7. Asnjë anëtar i Kryesisë, Kuvendit nuk mund të deklarohet në publik ose me forma të tjera, për çështjet e diskutuara në mbledhjen e Kryesisë ose Kuvendit kur për to vendoset të jenë të mbyllura.
8. Për vendimet që merren në Grupin Parlamentar, në emër të Grupit dhe në përputhje me vendimin politik të tij, shprehet Kryetari i Grupit dhe në raste të veçanta një deputet i caktuar nga Kryetari i Grupit Parlamentar.
9. Pjesëmarrësit në debatet publike si përfaqësues të ASH-së konsultohen paraprakisht me sektorët përkatës (Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun) lidhur me qëndrimet e Partisë për çështjet në diskutim.

KOMISIONI I GARANCIVE TË ETIKËS

Qëllimi

Neni 12

1. Për shqyrtimin e çështjeve që lidhen me zbatimin e Kodit të Etikës në Parti, ngrihet dhe funksionon Komisioni i Garancive të Etikës i ASH-së
2. Komisioni i Garancive të Etikës i ASH-së ka autoritetin për respektimin dhe zbatimin e këtij Kodi dhe për të ndërhyrë në trajtimin e zgjidhjen e konflikteve që lindin në çdo nivel të partisë për çështje që lidhen me respektimin e Kodit të Etikës.
3. Komisioni i Garancive të Etikës i ASH-së vepron edhe në rastet e fyerjeve, cenimit të personalitetit dhe kërcënimeve të një anëtari partie ndaj një anëtari tjetër, si të papranueshme për etikën dhe që u nënshtrohet sanksioneve statutare.

Kompetencat e Komisioni i Garancive të Etikës i ASH-së dhe marrja e vendimit

Neni 13

1. Për zbatim të Kodit të Etikës, Komisioni i Garancive të Etikës i ASH-së ka për kompetencë:
 - a) Të shqyrtoj ankimet për shkeljen e rregullave të parashikuara në Kod;
 - b) Të rekomandojë marrjen e masave sipas instancave përkatëse të strukturave e forumeve të partisë ku është konstatuar shkelja;
 - c) Te jap opinione, këshilla e rekomandime për zbatimin e normave të etikës të parashikuara në këtë Kod;
 - d) Të propozoj ndryshime e rregullime në përmbajtjen e Kodit të Etikës.
2. Në trajtimin e çështjeve Komisioni i Garancive të Etikës vendos me shumicë votash të anëtarëve të tij dhe jo më vonë se 30 ditë nga paraqitja e ankesës.

Neni 14

1. Çdo anëtar partie ka të drejtë t'i drejtohet Komisioni i Garancive të Etikës kur pretendon se janë shkelur rregullat e parashikuara në Kod, si dhe në rastet e fyerjeve ose cenimit të personalitetit të tij.
2. Anëtarët e forumeve drejtuese kanë të drejtë t'i kërkojnë opinionin dhe këshilla

- Komisionit të Garancive të Etikës për shmangien e konfliktit të interesave në një rast konkret.
3. Strukturat e partisë ose anëtarë të veçantë të saj kanë të drejtë t'i kërkojnë Komisionit të Garancive të Etikës marrjen e masave në raste të shkeljes së rregullave të etikës në marrëdhëniet publike të përvaktuara në Kod.
 4. Komisioni i Garancive të Etikës i ASH-së për çdo çështje që i shkon për gjykim, gjatë shqyrtimit, bën verifikimet përkatëse dhe mbledh informacionin e nevojshëm. Anëtari që ka lidhje me çështjen objekt shqyrtimi ka të drejtë të paraqesë opinionin e tij përpara Komisionit.
 5. Për çdo rast kur konstatohet shkelje e Kodit të Etikës në vendimin që merr, Komisioni i Garancive të Etikës parashikon masat disiplinore për korrigjimin e shkeljeve për strukturat dhe forumet përkatëse të partisë ku është konstatuar shkelja.
 6. Asnjë anëtar i ASH-së nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të vlerësimit të etikës së sjelljes dhe komunikimit, nëse ndaj tij nuk ekzistojnë fakte që ai ka vepruar në kundërshtim/ose ka shkelur me vetëdije rregullat e përfshira në këtë Kod.
 7. Vendimet e Komisionit të Garancive të Etikës me masat dhe rekomandimet për korrigjimin e shkeljeve të Kodit të Etikës janë të detyrueshme për ti zbatuar nga strukturat e forumet përkatëse të Partisë që u adresohen.

Neni 15

Kodi i Etikës së ASH-së hyn në fuqi ditën e miratimit të tij në Kryesi të Partisë.